



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 325, datë 30.12.2019

PËR

CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 e 89 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionin dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatën në nevojë si vijon:

GJYKATA E APELIT VLORË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokstër, Irena Brahimi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen penale me kërkuese: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; në ngarkim të të pandehurve: {...}, {...}, {...}, {...}; të akuzuar për kryerjen e veprave penale: “Shpërdorim detyre”, “Falsifikim i dokumentave”.

2. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokstër, Enton Dhimitri (relator), Irena Brahimi dhe Izet Salaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me kërkues: {...}; me objekt: “Kërkesë për revokimin e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. {...} të vitit 2017 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, e miratuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. {...}, datë 30.05.2019, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. {...}, datë 30.05.2019”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR
KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**